



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi dhe Kulturë e Gjuhës B

Ngarkesa: kredite 6: 60orë; 30 orëleksione /30 orëseminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në Komunikim Kulturor dhe Turistik trigjuhësh

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të zgjerojë njohuritë e studentëve mbi zhvillimet kulturore, letrare dhe shoqërore të shekullit XX dhe fillimshkullit XXI në kontekstin e vendeve të gjuhës A dhe B. Ajo fokusohet në ndërtimin e një komunikimi të ndërsjelltë kulturor përmes analizës së përfytyrimeve reciproke dhe të imazhit të vendit përmes letërsisë migratore, artit, filozofisë dhe mediave. Studentët pajisen me mjete teorike dhe praktike për të analizuar dhe ndërtuar rrëfime kulturore që mund të përkthehen në itinerare të turizmit kulturor.

Objektiva specifike lëndore:

- 1.Të pajisë studentët me njohuri dhe qasje analitike për të kuptuar dhe interpretuar karakteristikat e shoqërive moderne dhe postmoderne në kontekstin kulturor dhe turistik.
- 2.Të zhvillojë aftësinë për të lidhur faktet historike, kulturore dhe artistike dhe për të zbuluar stereotipet kulturore përmes analizës së veprave artistike në një këndvështrim komparativ.
- 3.Të nxisë reflektimin kritik mbi imazhin e shoqërisë shqiptare dhe asaj frankofone përmes leximit të letërsisë migratore të shkruar në frëngjisht.

Rezultate të pritshme:

Në përfundim të kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje:

- 1.Të vendosë paralele midis shoqërive të dy vendeve (asaj ku jeton dhe asaj gjuhën e së cilës mëson) duke evidentuar ngjashmëritë dhe ndryshimet përmes qasjeve krahasimore.
- 2.Të bëjë një interpretim personal të auto dhe heterostereotipeve duke shpjeguar shkaqet e lindjes së tyre dhe pasojat në një komunikim kulturor
- 3.Të shkruajë ese ku të bëjnë sprovat e para për të ndërtuar një komunikim turistik të thjeshtë të orientuar nga turizmi kulturor.